

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

**02.02.2024  
Ora 12:07**

***RENDI I DITËS***

***Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.***

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, në seancën e sotme në rend dite kemi, plotësimin e vakancës për disa këshilla bashkiakë dhe shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Qazim Bici, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet. Po!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Këshillat e Bashkisë Belsh, Shijak, Rrogozhinë, Lezhë, Kurbin, Sarandë dhe Has, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, në këshillat e tyre. Kandidatët vijues nga listat shumemërore të partive përkatëse kanë plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, rezulton se përveç kandidatit Ervin Gjoni të Bashkisë Lezhë, të tjerët nuk kanë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138/2015. Zoti Ervin Gjoni, ka deklaruar disa vendime penale gjyqësore në Shqipëri dhe në shtete të huaja. Gjithashtu ka deklaruar se ka qenë në hetim dhe gjykim nga

***Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU***

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

një autoritet i huaj, ka qenë i ndaluar dhe i arrestuar si dhe ka jetuar më shumë se një muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nga konstatimet e mësipërme, bazuar në nenin 3, pika 1 të ligjit 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi ta kalojë rastin për hetim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme dhe ky vendim ende nuk ka ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë kanë ardhur disa përgjigje. Nga DPGJC nuk ka ardhur përgjigje për tre kandidatët të Kurbinit, Sarandës dhe të Hasit. DPGJGJ ka dërguar verifikimin e të dhënave për kandidatët ku përveç zotit Ervin Gjoni, i cili rezulton i rihabilituar, kandidatët e tjerë rezultojnë të padënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte bazuar në pikën 2, Kreu V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive: Belsh, Shijak, Rrogozhinë, Lezhë, Kurbin, Sarandë dhe Has nuk janë në kushtet e ndalimit dhe moszgjedhshmërisë së tyre në funksionin e këshilltarit. I propozojmë Komisionerit që të vazhdohet me dhënien e mandateve për këto këshilla bashkiakë, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Belsh, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Erjon Qafa.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Mimoza Xhiani.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Demokratike, zonjën Merilin Saraçi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialdemokrate, zotin Elton Bilani.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialdemokrate, zotin Argert Përkola.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialdemokrate, zotin Erin Gjoni.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kurbin, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Republikane Shqiptare, zotin Hilmi Vuthaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, zotin Indi Rrapaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Has, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Shefqet Dauti.

**Vendimi nr. 09, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17.**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

02.02.2024

Ora 12:12

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Qazim Halil Bici, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Qazim Bici, propozuar nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

**Z. Y. Merkaj:** Në bazë të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionet publike si dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “kandidati për anëtar në këshillin e bashkisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Qazim Bici, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, më datë 29.03.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 8438.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

KQZ bëri verifikimin paraprak dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka qenë i dënuar me vendim penal të formës së prerë nga një autoritet i huaj. Ka qenë në hetim dhe gjykim nga një autoritet i huaj. Ka qenë i ndaluar dhe i arrestuar nga organet ligjzbatuese. Gjithashtu ka qenë dhe me masë shtrënguese të sigurisë personale dhe ka deklaruar se ka jetuar më shumë se një vit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Qazim Halil Bici. Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se zoti Qazim Bici, në bazë të vendimit penal me nr. 91, dt. 22.02.2001, të Gjykatës së Apelit të Campobasso në Itali, është deklaruar fajtor për veprën penale të “trafikimit të lëndëve narkotike”, e cila e konvertuar me Kodin Penal Shqiptar është i parashikuar nga neni 283/a, pika 2 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe është dënuar me gjashtë vjet burgim. Vepra penale “Trafikimi Narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a, pika 2 i Kodit Penal, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar të nenit 2, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.138/2015. Zoti Qazim Bici gjithashtu nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit gjeneralitetet e tjera të përdorura prej tij, që sipas rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm janë Ardian Arukaj, Gzim Shala dhe Fabrizio Albartimi. Mos deklarimi i gjeneraliteteve të tjera të mëparshme të përdorura prej tij, gjë që bie ndesh me pikën 3, shkronja “ç”, të Kreut III të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.02.2024*

vendimin nr. 578, datë 24.04.2023 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Shijak, Qarku Durrës dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023. Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka marrë një mandat në Këshillin e Bashkisë Shijak dhe kandidati zoti Qazim Bici, i renditur në listën shumëmemërore me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë), potencialisht mund të përfitojë mandatin e anëtarit të këshillit të bashkisë në këtë legjislaturë. Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, vlerësohet se zoti Qazim Bici, është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në funksion publik. Për këto arsye, bazuar në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të shpallë të pavlefshëm mandatin pasi kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë janë verifikuar pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Kemi çështje tjetër?

**Z. Y. Merkaj:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Nuk kemi çështje tjetër, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 18**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

